



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:088300
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500158

2024:088300

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen përbarimore të kreditorit A.V., nga Gjakova, të cilin e përfaqëson av. Martin Komani me seli në Prishtinë, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” me seli në Gjakovë, sipas dokumentit përbarimor – aktgjykimit C.nr.33/21 i datës 13.04.2022, për shkak të pagesës së shpërblimit jubilar në lartësi prej 695.00 euro, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, ndaj urdhrorit mbi lejimin e përbarimit, të përbaruesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, P.nr.346/24 të datës 01.03.2024, jashtë seancës, me datën 25 Mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” me seli në Gjakovë i ushtruar ndaj urdhrorit përbarimor të përbaruesit privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, P.nr.346/24 të datës 01.03.2024 mbi lejimin e përbarimit.
- II. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përbarimore.

A r s y e t i m

Kreditori A.V., nga Gjakova, të cilin e përfaqëson av. Martin Komani me seli në Prishtinë, me datë 01.03.2024 ka parashtruar propozim për përmbarim, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, sipas dokumentit përmbarimor – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me numër C.nr.33/21 i datës 13.04.2022, i plotfuqishëm prej datës 12.01.2024, dhe i ekzekutueshëm nga data 01.03.2024, për shkak të të pagesës së shpërblimit jubilar në lartësi prej 695.00 euro dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 299.00 euro, dhe shpenzimet përmbarimore.

Përmbaruesi privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, me urdhrin përmbarimor P.nr. 346/24 të datës 01.03.2024, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Ndaj urdhrin të lartcekur, me datën 08.03.2024, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim debitori, duke theksuar ndër të tjera se e kundërshton në tërësi propozimin për përmbarim, për shkak se pagat jubilarë të kreditorit Spitali nuk ka mundësi që t’i ekzekutoj pasi që nuk është paraparë vija buxhetore për këtë kategori, andaj nuk ka mundësi objektive që ta përmbushë këtë detyrim. Po ashtu ka theksuar se Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore C.nr.33/21, me datë 10.05.2022 ka paraqitur ankesë në gjykatën e Apelit, dhe për të njëjtin ende nuk është marrë aktgjykim i formës së prerë. Ka propozuar që kreditori të bëjë tërheqjen e propozimit dhe të aprovohet prapsimin.

Me datën 13.03.2024, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me propozim që prapsimi të refuzohet si i pa bazuar dhe urdhëri përmbarimor P.nr.346/24, të mbetet në fuqi. Dhe ndër të tjera ka theksuar se Gjykata e apelit kundrejt ankesës me datë 15.01.2024, ka marrë aktgjykim Ac.nr.4327/2022 duke e refuzuar si të pa themeltë ankesën e të paditurës, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Ka propozuar që gjykata të të refuzojë prapsimin e debitorit si të pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor si dhe ka kërkuar shpenzimet.

Gjykata duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, pas vlerësimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se:

- prapësimi është në tërësi i pa bazuar.

Me nenin 21 të Ligjit për procedurën përbarimore është paraparë që *“organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përbarim për kompensimin e dëmit në lartësi prej 695.00 euro dhe shpenzimet 299.00, sipas dokumentit përbarimor – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.33/21 i datës 13.04.2022, i plotfuqishëm prej datës 12.01.2024, dhe i ekzekutueshëm nga data 01.03.2024, i cili aktgjykim ka titull përbarues, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku në mënyre eksplicite parashihet se: *“ par.1 Dokumentet përbaruese janë: 1.1. vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përbarues;”*, dhe ky vendim është i përbarueshëm në bazë të nenit 24 par 1 të LPP-së, ku theksohet se *“ vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare “*, pasi që i njëjti ka marrë formën e prerë me datë 12.01.2024, si dhe ka skaduar afati për përmbushje vullnetare dhe i njëjti është bërë i ekzekutueshëm që nga data 01.03.2024, si dhe njëkohësisht është edhe i përshtatshëm për përbarim në kuptim të nenit 27 par.1 të LPP-së, ku thuhet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*,pasi që në aktvendimin sipas së cilit është lejuar urdhri përbarimor janë të përfshira të gjitha këto elemente, andaj gjykata ka vlerësuar së ky vendim i plotëson të gjitha kushtet e lartcekura ligjore për tu caktuar dhe zbatuar përbarimi sipas tij.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit se ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore C.nr.33/21, me datë 10.05.2022 ka paraqitur ankesë në gjykatën e Apelit, dhe për të njëjtin ende nuk është marrë aktgjykim i formës së prerë.

Mirëpo gjykata lidhur me këtë pretendim erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe pa mbështetje ligjore, pasi që gjykata vlerëson se dokumenti përbarimor në bazë të cilit është lejuar përbarimi i plotëson kushtet e parapara ligjore që të mund të konsiderohet dokument përbarimor, po ashtu në shkresa të lëndës dokumenti përbarimor është i bashkangjitur në versionin origjinal, dhe po ashtu pretendimi i debitorit se ndaj aktgjykimit të

Gjykatës Themelore C.nr.33/21, me datë 10.05.2022 ka paraqitur ankesë në gjykatën e Apelit, dhe për të njëjtin ende nuk është marrë aktgjykim i formës së prerë, tashmë nuk qëndron pasi që Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.4327/2022, ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.33/2021, të datës 13.04.2022, andaj Gjykata ka vlerësuar që nuk ka pengesa ligjore për lejimin e përmbarimi.

Gjykata aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 të LPP-së, pasi që gjeti se pretendimet e paraqitura në prapësim nga ana e debitorit nuk hyjnë në shkaqet e parapara me këtë nen, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, si dhe në nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ku theksohet se *“baza e prapësimit duhet të mbështetet me provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, pasi që debitori nuk ja ka bashkangjitur as edhe një provë të vetme me shkrim prapësimit, e cila do të mund të ndryshonte mënyrën e vendosjes së këtij aktvendimi.

Në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktvendimi gjykata është bazuar në nenin 77 paragrafi 5 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-
2024:088300, me datën 25 Mars 2024

G J Y Q T A R J A

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.